



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Datë: 22.05.2025

Numër Protokolli: 3404/2025

A.nr.537/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti, kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Flakron Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurën sipas ankesës me numër A.nr.537/2025, të datës 25.03.2025, të parashtruar nga ankuesja F.S, kundër organit të punësimit/Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, në çështjen juridike “*Vlerësim i rezultateve në punë*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3, dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2, dhe 1.3 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 22.05.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Apropohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.537/2025 e datës 25.03.2025 e parashtruar nga ankuesja F.S.

II. Ndryshohet Formulari për Vlerësimin e Rezultateve në Punë i datës 22.02.2025 lidhur me notën e përgjithshme të vlerësimit për ankuesin dhe atë nga “*e papranueshme*”, bëhet “*arrin pritshmëritë*” për periudhën kohore të vlerësimit, nga data **10.10.2024** e deri më **31.12.2024**.

III. Ky vendim zëvendëson Formularin e Vlerësimit të Rezultateve në Punë për ankuesen si në pikën **II** të dispozitivit dhe i njëjti duhet të përfshihet në dosjen personale dhe regjistrat përkatës të nëpunësit civil.

IV. Obligohet Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, që të ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme administrative për zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimi të tij.

V. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Nëpunësi civil F.S (në tekstin e mëtejme referuar Ankuesja), më datë 11.03.2025 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër vlerësimit të rezultateve në punë të datës 28.02.2025, nga ushtruesja e detyrës së Sekretares së Përgjithshme të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë për periudhën nga data 11.10.2024 deri më datë 31.12.2024.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 01.04.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (tutje referuar MINT), ndërsa kjo e fundit më datë 08.04.2025 ka dërguar përgjigje në ankesë.

Kryetari i Këshillit me datë 06.05.2025 ka nxjerrë Vendimin me shifër VK/2025 dhe numër protokolli:3041/2025, përmes të cilit ankesës së ankueses nën shenjë A.nr.537/2025 të datës 25.03.2025 ia ka vazhduara fatin e vendimmarrjes edhe për dhjetë (10) ditë të tjera, ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) për vendosje meritore administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 1973/2025 e datës 25.03.2025 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Formularin e vlerësimit të rezultateve në punë i datës 28.02.2025; Formularin e vlerësimit të rezultateve në punë i datës 28.01.2022; Formularin e vlerësimit të rezultateve në punë i datës 08.02.2023; Formularin e vlerësimit të rezultateve në punë i datës 15.02.2024; vendimin e datës 19.09.2024; Dëshmi rreth përmbushjes së detyrave të punës (vendimeve, shkresa zyrtare, e-maili raporte) gjatë vitit 2024; Kërkesa për përgjigje në ankesë e datës 01.04.2025; Përgjigje në kërkesë e datës 08.04.2025; E-mailin e datës 07.04.2025 dërguar nga E.K për Njësine e Burimeve Njerëzore; Akt Emërimit të ankueses të datës 22.01.2019 me përshkrimin e detyrave të punës; Vendimin e datës 08.03.2024 të Ministres së MINT; Vendimin 19.09.2024 të Ministres së MINT; Vendimin 10.10.2024 të Ministres së MINT; Akt Emërimit të zyrtares E.K të datës 27.02.2024; E-mailin e datës 14.03.2025 dërguar nga F.S për E.K; E-mailin e datës 17.03.2025 dërguar nga ankuesja për E.K; Procesverbal me shifër 001784/24; Tabelë me aktivitete të përcaktuara të punës; Vendimin e Këshillit të datës 06.05.2025 me shifër VK/2025; Vendimin e Këshillit A.nr.2132/2024 të datës 25.02.2025; Vendimin e Njësies së Burimeve Njerëzore të MINT i datës 10.10.2025.

Kolegji i Këshillit, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të parashtruar nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankueses **është e bazuar sepse:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës, Kolegji i Këshillit ka konstatuar se ankuesja sipas Akt të Emërimit të datës 22.01.2019, mban pozitën “Inspektor i Tregut” në Inspektoratin e Tregut/Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, ndërsa sipas Vendimit të datës 08.03.2024 më shifër Nr.Ref.01/17 nga Ministria e MINT ankuesja është emëruar Zëvendësues e Kryeinspektorese së Inspektoratit të Tregut, pozitë të cilën e ka ushtruar deri me datë 10.10.2024, ashtu që përmes Vendimit të datës 10.10.2024 me shifër Nr.01/64 të Ministres së MINT, ankuesja është liruar nga pozita e

Zëvendësues e Kryeinspektore së Inspektoratit të Tregut duke u kthyer në ushtrimin e detyrave të punës sipas katit të emërimit, pasi që Zëvendësuese e Kryeinspektore së Inspektoratit të Tregut tani është caktuar zyrtarja E.K.

Zëvendësuesja e Kryeinspektore së Inspektoratit të Tregut, për periudhën kohore nga data 10.10.2024 e deri me datë 31.12.2024, ankuesen e ka vlerësuar me notën e përgjithshme të vlerësimit: **E papranueshme**, sipas formularit për vlerësimin e rezultateve në punë të datës 28.02.2025.

Ankuesja në ankesën e parashtuara në Këshill, kërkon që ankesa e saj të aprovohet, ashtu që të anulohet formulari i vlerësimit të rezultateve në punë për vitin 2024, me pretendimin ankimor se vlerësimi i saj është bërë në kundërshtim me dispozitat e ligjit material dhe shkeljeve materiale si dhe konstatimit jo të saktë të gjendjes faktike, pasi që e njëjta pretendon se i ka përmbushur detyrat e saj të punës, përderisa thekson se udhëheqësja e saj përveç që pozitën e ushtron në kundërshtim me nenin 35 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, po ashtu ankuesja kërkon që Këshilli ta detyroi Njësinë e Burimeve Njerëzore të MINT që t'ia mundësojë që e njëjta të mund t'i vlerësoj vartësit e saj, për kohën sa ka qenë duke e ushtruar pozitën e Kryeinspektore Inspektoratit të Tregut dhe atë nga data 08.03.2024 e deri 10.10.2024. Me qëllim të shqyrtimit të pretendime ankimore të ankuesit, Kolegji i Këshillit mori për bazë dispozitat e nenit 52 paragrafi 1, 2, 3, 4 dhe 13 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, ku përcaktohet se: “**1. Vlerësimi i rezultateve në punë është proces i vazhdueshëm, që përfshin vlerësimin e realizimit të objektivave të paracaktuara, vlerësimin e aftësisë profesionale, metodologjike, personale dhe sociale të nëpunës/it civil në realizimin e objektivave dhe përmbushjen e përgjithshme të përgjegjësisë të njësisë. 2. Periudha e vlerësimit zgjat një (1) vit, nga 1 janari deri me 31 dhjetor. Procedura e dhënies së vlerësimit përfundon deri më 28 shkurt të vitit pasues. 3. Vlerësimi i rezultateve në punë bazohet në: 3.1. realizimin e objektivave të paracaktuara në planin vjetor individual, përmbushjen e detyrave të punës në përputhje me përshkrimin përkatës të punës, objektivat e njësisë dhe institucionit, si dhe kryerjen e detyrave të atypëratyshme që nuk janë paracaktuar paraprakisht apo nuk kanë mundur të paracaktohen; 3.2. aftësitë profesionale të shfaqura nga shërbyesja/i civil gjatë ushtrimit të detyrës, si dhe sjelljen profesionale; 3.3. aftësitë metodologjike, personale dhe sociale të shfaqura nga shërbyesja/i civil gjatë ushtrimit të detyrës. 4. Përcaktimi i objektivave individuale të nëpunës/it civil bëhet nga mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë në bashkëpunim me nëpunësen/in dhe përfaqësuesen/in e njësisë së burimeve njerëzore, me shkrim, në muajin janar të çdo viti, së bashku me planin individual të punës për arritjen e këtyre objektivave, 13. Nivelet e vlerësimit të rezultateve në punë janë: 13.1. arritje e jashtëzakonshme; 13.2. tejkalon pritshmëritë; 13.3. arrin pritshmëritë; 13.4. **ka nevojë për përmirësim**; 13.5. **e papranueshme**.”**, rrjedhimisht në kuptim të këtyre dispozitave ligjore si dhe bazuar në shkresat e lëndës rezulton së ankuesja për periudhën e vitit 2024 (nga data 10.10.2024 deri 31.12.2024) lidhur me pjesën e përmbushjes dhe realizimit të objektivave të punës dhe aftësive profesionale, është vlerësuar me notë të përgjithshme: **e papranueshme**.

Duke marr parasysh dispozitat e cekura si më lartë, dhe po ashtu duke marr parasysh provat materiale të lëndës, gjegjësisht formularin e vlerësimit të rezultateve në punë për vitin 2024, Kolegji i Këshillit konstaton se sipas vlerësimit të ankueses për vitin 2024 me notën e përgjithshme: **e papranueshme**, rezulton se ankuesi nuk ka arritur të përmbushë objektivat e paracaktuara të punës, gjegjësisht ka dështuar të përmbushë në mënyrë të plotë pritshmërinë dhe kërkesat për rolin e saj, ngase duke marr parasysh

dispozitat e Rregullores NR.26/2024 Për Vlerësimin e Rezultateve në Punë, gjegjësisht nenin 9 paragrafi 3 nën paragrafi 3.5, përcakton se: ***“E papranueshme”*** është vlerësim që tregon se nëpunësi civil ka dështuar të përmbushë në mënyrë të dukshme dhe të përsëritur pritshmërinë dhe kërkesat për rolin e tij. Performanca është shumë poshtë standardeve të përcaktuara dhe kërkohet veprim i menjëhershëm për përmirësim”.

Pas analizimit të dispozitave të aplikuara ligjore të ligjit material që rregullon çështjen e vlerësimit të rezultateve në punë, Kolegji i Këshillit nga shkresat e lëndës ka konstatuar se udhëheqësja e drejtpërdrejtë e ankueses, të njëjtës nuk ia ka përcaktuar objektivat e punës në fillim të vitit 2024, respektivisht është vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 52 paragrafi 4 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrat e Publik, ku përcaktohet se: ***4. Përcaktimi i objektivave individuale të nëpunës/it civil bëhet nga mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë në bashkëpunim me nëpunësen/in dhe përfaqësuesen/in e njësisë së burimeve njerëzore, me shkrim, në muajin janar të çdo viti, së bashku me planin individual të punës për arritjen e këtyre objektivave”***, ndërlidhur edhe me nenin 4 paragrafi 1 të Rregullores Nr.26/2024 për Vlerësimin e Rezultateve në Punë, pasi që Këshilli me rastin e dërgimit të kërkesës për përgjigje në ankesën e ankueses tek MINT, me datë 01.04.2025 ndër të tjerash në cilësi të shkresave të lëndës janë kërkuar, si në vijim: ***“Dëshmi me shkrim lidhur me përcaktimin e objektivave të punës për pozitën që ankuesja mban në kohën e vlerësimit”***, ndërsa në përgjigjen e pranuar të datës 08.04.2025 me provat e lëndës të ofruara nga Njësia e Burimeve Njerëzore, konfirmohet fakti se një parakusht i tillë ligjor nuk është plotësuar, respektivisht del se vlerësuesja e ankueses marrëdhënien e punës në MINT e ka themeluar me datë 26.02.2024, kurse në përgjigjen përmes emailit të datës 07.04.2024 drejtuar Njesisë së Burimeve Njerëzore të MINT-it, ku shprehet se me rastin e vlerësimit janë pajtuar për objektivat, është i paqëndrueshëm, pasi që objektivat përcaktohen në fillim të vitit, respektivisht në muajin janar për vitin në të cilën vlerësohet, kurse Zëvendësuesja e tanishme e Kryeinspektores së Inspektoratit të Tregut, në muajin janar të vitit 2024 nuk e ka pasur të themeluar as marrëdhënien e punës në MINT.

Me rastin e shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankueses, Kolegji i Këshillit mori përbazë po ashtu edhe dispozitat nga neni 9 paragrafi 2 të Rregullores Nr.26/2024 për Vlerësimin e Rezultateve në Punë, ku përcaktohet se: ***“2. Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë gjatë procesit të vlerësimit është i obliguar të vlerësojë nëpunësin në mënyrë objektive dhe të argumentojë vlerësimin”***, kurse në formularin e vlerësimit të rezultateve të punës i datës 28.02.2025 të vetmin koment që vlerësuesja e ka bërë është qartësimi se vlerësimi është bërë për periudhën nga data 10.10.2024 deri 31.12.2024, nga rrjedh se nuk e ka argumentuar me asnjë pjesë vlerësimin me notën e përgjithshme: ***e papranueshme***, i cili njëherit është vlerësim më i ulët në kuadër të Shërbimit Civil, mirëpo përkundër saj vetë vlerësuesja apo Zëvendësuesja e Kryeinspektores së Inspektoratit të Tregut, tek pjesa e aktiviteteve të përcaktuara në formularin e datës 28.02.2025 ka evidentuar 20 lloje të aktiviteteve, ndër të tjerash veprime të matshme apo aktivitetet të realizuara nga ankuesja, citoj: ***“Inspektime të realizuara në teren-gjithsejtë 85; Inspektime në zonën doganore-gjithsejtë 5; Inspektime në Policinë e Kosovës-gjithsejtë 1; Inspektime me institucione tjera -gjithsejtë 1 (në kazermën e FSK-së; Aktvendime për shqiptim gjobe-gjithsejtë 9; Aktvendime për ndalim veprimtarie-gjithsejtë 2; Vlera totale shqiptimit të gjobave-gjithsejtë 9000€; Lëndë të iniciuara në Gjykatë-gjithsejtë 7; Vlera totale e shqiptimit të gjobave nga Gjykata-gjithsejtë 47950€; Mostra diezel dhe benzinë-gjithsejtë 47; Mostra vajra motorike-gjithsejtë 9; Mbyllje të lokalit-gjithsejtë 3; Pjesëmarrje në seanca gjyqësore-gjithsejtë 9; Produktet të ndaluara në tregun e brendshëm-12800 litër diezel dhe 6556 litër derivate tjera jo cilësore”***, prandaj thënë si më lartë, vlerësimi ankueses

përveç që nuk është real, i njëjtë ka shpërputhje për aq kohë sa institucioni punëdhënës nuk ka arritur të përcaktojë se cilat kanë qenë objektivat e përcaktuara të ankueses, ndërsa është evidentuar një numër i lartë i aktiviteteve dhe veprimeve të ndërmarra nga ankuesja, madje kjo e përcaktuar dhe deklaruar nga vlerësuesja si në formularin e kontestuar.

Përveç tjerash, Kolegji i Këshillit thekson faktin se vlerësuesja e ankueses, respektivisht Zëvendësuesja e Kryeinspektorese së Inspektoratit të Tregut, në sqarimin e dhënë të datës 07.04.2024, në kuptim të sjelljeve jo etike të ankueses, i është referuara edhe vërejtjes së datës 13.12.2024, me aludimin se e njëjta vërejtje me datë 28.02.2025 (*me rastin e vlerësimit ka qenë në fuqi*), mirëpo me këtë rast është dashur ta ketë pasur parasysh fuqinë ligjore të dispozitës nga neni 144 i LPPA-së, ashtu që një akt nuk mund të bëhet i ekzekutueshëm pa kaluar afati ankimor i përcaktuar, përkundër që ankuesja lidhur me vërejtjen në fjalë kishte parashtruar ankesë në Këshill, madje Këshilli me datë 25.02.2025 ka nxjerrë Vendimin A.nr.2132/2024, përmes të cilit i ka aprovuar ankesën e ankueses ndërsa e ka anuluar vërejtjen e datës 13.12.2024, madje organi i punësimit, MINT përmes Vendimit të datës 10.03.2025 e ka njoftuar Këshillin për zbatimin e vendimit, nga rrjedh se një çështje e hapur disiplinore, pa pasur vendim përfundimtar apo të formës së prerë në procedurë administrativ, nuk mund të merret si fakt i kryer apo notor, kurse në rastin konkret është përdorur si fakt për përkeqësimin e situatës juridike në dëm të palës ankuese.

Ndër të tjera, përveç të gjeturave të lartcekura Kolegji i këshillit nga shkresat e lëndës arriti në përfundimin se ankueses, udhëheqësja e saj e drejtpërdrejtë gjatë vitit 2024, nuk i ka kërkuar performancë më të mirë, evitimi të lëshimeve apo sugjerim që ndërlidhet drejtpërsëdrejti me arritjen e objektivave, prandaj, nga se u tha si më lartë në arsyetimin e këtij vendimi, si dhe duke vlerësuar faktin se ankuesja në vlerësimin paraprak sipas Formularit të vlerësimit të rezultateve të punës për vitin 2021 i datës 28.01.2022 ka qenë e vlerësuar me notë të përgjithshme mesatare **4.4**, sipas Formularit të vlerësimit të rezultateve të punës për vitin 2022 i datës 08.02.2023 ka qenë e vlerësuar me notë të përgjithshme mesatare **4.4**, sipas Formularit të vlerësimit të rezultateve të punës për vitin 2023 i datës 15.02.2024 ka qenë e vlerësuar me notë të përgjithshme mesatare **4.3**, apo **“shumë mirë”** sipas dispozitave të Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimit Publik, andaj Kolegji i Këshillit e ndryshon formularin e vlerësimit të rezultateve të punës së ankueses, duke vendosur që nota e vlerësimit të rezultateve në punë për ankuesen për periudhën kohore nga data 10.10.2024 e deri 31.12.2024 të jetë **“arrin pritshmëritë”** sikurse në dispozitiv të këtij vendimi, ngase organi i punësimit nuk kishte arritur ta mbështesë me fakte të provueshme fillimisht se të njëjtës i janë caktuar objektivat përkatës dhe të matshme, se mbikëqyrësja i kishte tërhequr vërejtjen apo sugjeruar të njëjten për ngritje të performancës lidhur me arritjen apo realizimin e objektivave, nga lënë të kuptojë se në vlerësimin e ankueses është krijuar përshtypje se veprimet e saj janë në frymën e arritjes së objektivave të punës, për aq kohë sa nga udhëheqësja nuk ka pranuar vërejtje të tilla, si dhe duke prezantuar aktivitetet e njohura si në vetë formularin e kontestuar, andaj mbi këtë bazë si dhe provave të ofruara nga ankuesja dhe organi i punësimit, Kolegji i Këshillit vendosi që ankesën e ankueses të datës 25.03.2025 ta aprovojë si të bazuar, ndërsa të ndryshoi notën e vlerësimit si në dispozitivin e këtij vendimi.

Tutje, Kolegji i Këshillit thekson faktin se me qëllim të zbatimit të këtij vendimi, Njësia e Burimeve Njerëzore është e obliguar që vendimin e Këshillit A.nr.537/2025 të datës 22.05.2025 ta vendos në dosjen personale të ankuesit sipas përgjegjësiwe funksionale që ka në kuptim të dispozitave të ligjit material.

Po ashtu, Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të MINT-it, duke pasur parasysh parimet e menaxhimit të zyrtares/it publik, nga neni 8 i Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, ndërlidhur me nenin 52 të të njëjtit ligj, duhet të përmbush pjesën e përgjegjësisë dhe t'ia mundësoi ankueses që e njëjta ta bëjë vlerësimin e rezultateve të punës për vartësit e saj ndërmjet periudhës kohore nga data 08.03.2024 e deri me datë 10.10.2024 sa ka qenë duke e ushtuar detyrën e Kryeinspektorese së Inspektoratit të Tregut, nëse eventualisht deri më rastin e marrjes së këtij vendimi nuk kanë ndryshuar rrethanat faktike apo nëse vlerësimi eventual është kryer.

Kështu që, në mbështetje te nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 dhe 1.3 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, si dhe nenit 132 paragrafi 4 i Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.
Vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij Vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda, A.nr.537/2025, datë 22/05/2025.

Flakron GASHI

Procesmbajtës

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses F.S;
- Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
(Kryeinspektorit të Inspektoratit të Tregut dhe Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore), si dhe;
- Arkivit të KPMSHCK-së.